#INNO4EDU

| Titulli i aktivitetit | |
|---|---|
| Lojë me ngjyra | |
| **Mosha** | |
| Periudha zhvillimore (nga 4 deri në 10 vjet) | |
| **Vendi / lokacioni** | **Vlera e karakterit** |
| Kushte shtëpie | Vetëbesim |
| **Koha e nevojshme për përgatitje** | **Koha e nevojshme për realizim** |
| 30 minuta | 20-25 minuta |
| **Qëllimet** | |
| Qëllimi është që fëmija të mbështetet gjatë të shprehurit dhe të shfaqurit të mendimeve dhe ideve të veta dhe të nxitet drejt respektimit të rregullave të vendosura të lojës. | |
| **Rezultate të pritshme** | |
| | |
| **Kahje** | |

**<u>Përgatitje paraprake për aktivitet</u>**

Fëmija, bashkë me prindin, vizatojnë forma me ngjyra, të cilat më pas i presin. Vizatohet një ylber dhe ngjyroset në fletë në format A4. Në dyshemenë e shtëpisë vendoset një shteg me “start” dhe forma të ndryshme me ngjyra (p.sh. rreth, katror, trekëndësh, drejtkëndësh në ngjyra të ndryshme) deri te caku, gjegjësisht tek ylberi. Bëhet legjendë simbolesh (të cilën e krijojnë anëtarët e familjes), për shembull nëse qëndron në rreth të kuq duhet të shkohet në fushë me trekëndësh të verdhë e të ngjashme (në marrëveshje me fëmijët).

Punim i një kubi për lojë.

**<u>Instrukcione / kahje për lojën</u>**

Në këtë lojë duhet të përkufizohen rregullat e lojës, gjegjësisht prindi bashkë me fëmijët e bëjnë kubin dhe legjendën e simboleve si të lëvizin nga fusha në fushë. Me rrotullimin e

kubit (sipas numrit që ka rënë bën po aq hapa), secili lojtar lëviz nëpër poligon nga fusha në fushë.

**Aktivitet / lojë**

Bashkë me fëmijën, në shtëpi, vendoset poligoni ku me fëmijët bisedohet për format dhe ngjyrat. Nëse luhet me fëmijë të moshës shkollore mundet në fusha të shkruhen detyra (mbledhje, zbritje, shumëzim dhe pjesëtim), për ta patur më interesant dhe të përsëriten operacionet matematikore. Përmes numratores përcaktohet rradha e lojtarëve. Fitues është ai anëtar i familjes i cili i pari do të arrijë tek caku.

| **Shtojca** | **Materiale** |
| --- | --- |
| | Fletë letre; selotejp; ngjyra; kub për lojë |

**Aktiviteti është përgatitur nga edukatorët:**

Krijuar nga: Sonja Çallovska, Vesna Peceva

Dizajni grafik: Katerina Nikolovska

